

## **RELACION MBI PROJEKTVENDIMIN**

**“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË ZHVILLIMIT TË GARËS, KRITERET SHITESË PËR APLIKANTËT QË KONKURROJNË PËR T’U PAJISUR ME LICENCË PËR KATEGORINË “KAZINO”, PROCEDURA E SHPALLJES SË FITUESIT, SI DHE RASTET E REVOKIMIT APO TË PEZULLIMIT TË KËSAJ LICENCE”**

### **I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ministria e Financave ka ndërmarë iniciativën për hartimin e projekt-vendimit me anë të së cilit përcaktohen kushtet dhe kërkesat që duhet të plotësojnë subjektet e interesuara për tu pajisur me licencë në kategorinë “Kazino”.

Ky projektvendim përvec kriterëve minimale dhe dokumentacionit të parashikuar në ligjin nr. 155/2015 “ Për Lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, detajon procedurën e zhvillimit të garës, kriteret shtesë që duhet të përmbushen nga subjektet aplikues. Në të njëjtën kohë parashikohet dhe procedura e shpalljes së fituesve dhe rastet e pezullimit apo revokimit të kësaj license.

### **II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave për plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e lojërave të fati dhe gjithashtu synon përcaktimin e procedurës së zhvillimit të garës që nga kriteret e aplikimit, procedura e shpalljes së fituesit dhe rastet e pezullimit apo revokimit të licensës për subjekte të cilët janë në gjendje të përmbushin të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji 155/2015 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Ky projektvendim është parashikuar në Programin Analitik të Ministrisë së Financave për vitin 2016, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 136, datë 24.02.2016, ndërkohë që tashmë do jetë pjesë e programit analitik për vitin 2017.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Hartimi i këtij projektvendimi ka si qëllim detajimin e procedurës së zhvillimit të garës, kriteret shtesë që duhet të përmbushen nga subjektet aplikues për licensë për “Kazino”. Në të njëjtën kohë parashikohet dhe procedura e shpalljes së fituesve dhe rastet e pezullimit apo revokimit të kësaj licence.

Përcaktimi i qartë i procedurës e cila nis me aplikimin, procedurën e zhvillimit të garës, shpalljes së fituesit dhe rastet e pezullimit apo revokimit të licensës për subjekte ofron një kuadër të mirë detajuar mbi gjithë procesin e aplikimit nga subjektet e interesuar për t’u pajisur me licensë në kategorinë “Kazino”.

Qartësimi i kriterëve që duhet të përmbushin organizatorët e lojrave të fatit, duke u shoqëruar dhe me detyrimet përkatëse për dhënien e licensës, do të mundësojë rritjen e përgjegjshmërisë nga subjektet e licensuara.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi është në harmoni të plotë me rendin e brendshëm juridik. Projektvendimi është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe del në zbatim të pikës 1, të nenit 36, të ligjit nr.155/2015 "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", në të cilat parashikohet që procedurat e zhvillimit të garës, kriteret shtesë për aplikantët që konkurrojnë për t’u pajisur me licensë për kategorinë “Kazino”, procedura e shpalljes së fituesit si dhe rastet e revokimit apo të pezullimit të kësaj licence përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE**

Projektvendimi nuk synon përafrimin e legjislacionit me Acquis Communautaire.

#### **VI. PËRMbledhje SHpjeguese e PËRMBAJTJES SË PROJEKT-VENDIMIT**

Procedurat e zhvillimit të garës, kriteret shtesë për aplikantët që konkurrojnë për t’u pajisur me licensë për kategorinë “Kazino” e procedura e shpalljes së fituesit, si dhe rastet e revokimit apo të pezullimit të kësaj licence, janë parashikuar të strukturohen në katër krerë si më poshtë:

## **Kreu I trajton dispozitat e përgjithshme dhe përmban 12 pika:**

Në pikën 1 është përcaktuar se çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose i huaj, i organizuar si shoqëri aksionare, që kërkon të pajiset me licencë për Kazino, duhet të aplikojë pranë autoritetit të autorizuar dhe të plotësojë kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.155/2015 "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", në këtë vendim dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Në pikën 2 është përcaktuar se autoriteti i autorizuar për dhënien e licensës për "Kazino" është Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit.

Në pikën 3 është përcaktuar se fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë vendim do të kenë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligj dhe aktet e tjera të dala në zbatim të tij, përveçse kur konteksti e kërkon apo kur, në përputhje me kontekstin e dhënë, në këto akte përcaktohet shprehimisht ndryshe. Plotësimi i kushteve dhe i kriterëve shtesë, të kërkuara për subjektet e huaja, bëhet sipas dokumentacionit të përcaktuar në legjisllacionin e huaj përkatës.

Në pikën 4 përcaktohet se Aplikimi përbëhet nga tërësia e dokumenteve të përcaktuara në këtë vendim, ku përfshihen dhe dokumentet që i kërkojnë aplikuesit nga Komisioni i Shqyrtimit të Aplikimit (në vijim "Komisioni"), si kusht për shqyrtimin dhe marrjen e një vendimi për licencim, në formën dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim.

Pika 5 përcakton se aplikuesi mund të paraqitet në formën e një bashkimi shoqërorish, në vijim "Bashkimi", i përbërë nga disa persona të tjerë juridikë, vendas ose të huaj. Bashkimi duhet të caktojë dhe të autorizojë njërin nga anëtarët e tij, si kryesues, për t'i përfaqësuar dhe për të marrë përsipër, në mënyrë të përvokueshme, detyrime në emër të të gjithë anëtarëve të bashkimit për të gjitha çështjet, në lidhje me procesin e shqyrtimit të aplikimit, përfshi dhe licencimin dhe dorëzimin e aplikimit në formën e kërkuar. Bashkimi duhet të formalizohet me anën e një kontrate noteriale të nënshkruar nga persona të autorizuar rregullisht nga shoqëritë që përbëjnë këtë bashkim.

Pika 6 përcakton detyrimin që bashkimi i përkohshëm të mos ndryshojë përbërjen e tij, pa miratimin paraprak, me shkrim, të autoritetit.

Pika 7 ka përcaktuar se në rast bashkimi, asnjë anëtar i tij nuk mund të marrë pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në një bashkim tjetër që aplikon për të njëjtin aktivitet, apo të paraqesë i vetëm një aplikim. Në rast se një gjë e tillë verifikohet, do të rezultojë në skualifikimin e aplikimit si të aplikuesit, ashtu dhe të bashkimit ku ky aplikues bën pjesë.

Pika 8 ka përcaktuar se aplikuesi do të përballojë të gjitha kostot në lidhje me përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit, duke përfshirë, ndër të tjera, të gjitha kostot dhe shpenzimet në lidhje me përgatitjen e përgjigjeve të pyetjeve apo kërkesave për sqarime a takime të Autoritetit.

Në pikën 9 përcaktohet se njoftimi për shpalljen e konkurimit për dhënien e licensës në kategorinë "Kazino", publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit, në dy gazeta që botohen në vendin tonën në dy numra radhazi, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Pika 10 ka të përcaktuar informacionin që duhet të përmbajë njoftimi i cili do të publikohet

Në pikën 11 është përcaktuar se kostoja e publikimit parapaguhet nga AMLF, shpallet në dokumentet e garës dhe rimburohet nga aplikuesi i shpallur fitues, jashtë tarifës, që do të paguajë për marrjen e licencës.

Pika 11 ka përcaktuar gjuhen në të cilën do të paraqitet aplikimi.

### **Kreu II parashikon procedurën për zhvillimin e garës dhe përmban 16 pika.**

Në pikat 1 deri në 6 të këtij Kreu janë parashikuar menyra edhe forma e dorëzimit të aplikimit. Gjithashtu, në këto pika është përcaktuar aplikuesi, së bashku me zarfin i cili do të përmbajë kopjen origjinale të aplikimit, duhet të dorëzojë dhe 1 (një) kopje tjetër, mbi të cilat të vërë qartë shënimin përkatës "Origjinal" dhe "Kopje.

Në pikat 7 deri në 10 është përcaktuar ngritja dhe organizimi i Komisionit të Shqyrtimit të Aplikimit. Ky komision do të ketë përfaqësues nga:

- a) Përfaqësues nga Ministria e Financave;
- b) Përfaqësues nga Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit;
- c) Përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomikë Tregëstisë dhe Sipërmarrjes;
- d) Përfaqësues nga Ministria e Mjedisit;
- e) Përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban;
- f) Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
- g) Përfaqësues nga Avokatura e Shtetit;

Në pikën 11 janë përcaktuar rregullat që duhet të mbahen parasysht nga anëtarët e komisionit gjatë procedurës së shqyrtimit të aplikimit.

Në pikën 12 deri në 15 janë përcaktuar afatet brenda të cilave komisioni duhet të shprehet lidhur me aplikimin, e drejta që i jepet komisionit për të kërkuar informacione nga shërbimet e inteligjencës nëse aplikanti është person juridik i huaj, afati që ka komisioni në dispozicion për të informuar me shkrim aplikantin lidhur me vendimin e tij si edhe, afati që aplikanti ka në dispozicion, për ankimimin tek Ministri i Financave, dhe ky i fundit duhet të kthejë përgjigje brenda 30 ditëve.

Në pikën 16 është përcaktuar se vendimi i Ministrit të Financave është përfundimtar nga ana administrative.

### **Kreu III përmban kushtet, kriteret shtesë dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet për pajisjen me licencë për kazino dhe përmban 18 pika.**

Në pikat 1 deri në 5 janë përcaktuar kriteret minimale që duhet të plotësojë aplikanti i cili do të nënshtrohet garës për marrjen e licencës për "Kazino".

Në pikën 6 është përcaktuar se aplikuesi duhet të paraqesë, së bashku me aplikimin e tij, në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga autoriteti, një garanci të aplikimit, në masën 2% të tarifës, që duhet të paguajë për marrjen e licencës. Nëse aplikuesi paraqitet në

formën e një bashkimi, garancia e aplikimit duhet të jetë në emër të të gjithë anëtarëve të bashkimit. Garancia e aplikimit sekuestrohet dhe kalon tërësisht në favor të buxhetit të shtetit, nëse ky i fundit vëren se aplikuesi:

- a. ka deklaruar të dhëna të rreme në aplikimin e tij;
- b. nuk ka paguar tarifën e licensimit brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti, në përputhje me këtë vendim;
- c. tërhiqet nga kërkesa për shqyrtimin e aplikimit të tij, pasi ky i fundit është paraqitur;

Në rast se aplikuesi nuk paguan shpenzimet për publikimin, atëherë këto shpenzime do të mbahen nga fondi i garancisë së aplikimit në masën përkatëse.

Në pikën 7,8 dhe 9 është përcaktuar se aplikuesi, ose nëse aplikuesi është bashkim, secili prej anëtarëve të bashkimit, duhet të paraqesin aktet e themelimit dhe statutet e tyre, së bashku me certifikatën nga organi që mban regjistrin tregtar në vend, ku të jenë evidentuar emrat e aksionarëve të tyre dhe përqindja që ata zotërojnë në kompani, emrat e aksionarëve, që zotërojnë të drejta të veçanta, emrat e anëtarëve të organeve drejtuese, si dhe të dhëna të tjera për organet drejtuese të tyre, në rast se kërkohet nga autoriteti.

Për aksionarët që zotërojnë paketën kryesore të aksioneve, duhet të paraqiten të dhëna personale sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Të dhënat duhet të paraqiten edhe nga të gjithë aksionarët pjesëmarrës në grupin influencues të aplikuesit, sipas dispozitave të legjislacionit tregtar.

Nëse aplikuesi zotërohet nga një shoqëri, aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacion të plotë në lidhje me aksionarët e shoqërisë, nga i cili të dalë qartë struktura e pronësisë së subjektit, informacioni për kapitalet dhe interesat e aksionarëve në shoqëri të tjera, si dhe të identifikohet deri në fund individit/individët përfitues.

Në pikën 10 është parashikuar se aplikuesi duhet të paraqesë pasqyrat financiare të audituara nga auditues të certifikuar ligjor, për tri vitet e fundit, të plota financiare,.

Në pikën 11 është parashikuar se aplikuesi duhet të paraqesë vetëdeklarim nga aksionarët e tij dhe anëtarët e organeve drejtuese, që vërteton se nuk është në ndjekje penale, si dhe është përcaktuar dokumentacioni i cili duhet ta shoqërojë këtë vetëdeklarim.

Në pikën 12 është përcaktuar se aplikuesi ose, nëse aplikuesi është bashkim, të paktën anëtari kryesues, për të plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3 të këtij kreu, ka të drejtë të paraqesë një evidencë për veprimtarinë e ndërmarrë nga "shoqëria mëmë".

Në pikën 13 është përcaktuar se aplikanti duhet të paraqesë një marrëveshje paraprake, të paktën me njërin nga bankat e nivelit të dytë, me seli në territorin e republikës së shqipërisë, për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave.

Në pikën 14 është përcaktuar se aplikuesi duhet të paraqesë vërtetim nga një institucion bankar që të vërtetojë se ka vendosur garanci për fituesit e lojrave të fatit në përputhje me pikën 1, të nenit 47, të ligjit për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë dhe ka depozituar në një llogari të vecantë të fondin e garancisë në favor të AMLF-së, për

shlyerjen e detyrimeve ndaj AMLF-së, organeve tatimore etj, në përputhje me pikën 2, të nenit 47, të ligjit për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë.

Në pikën 15 është parashikuar dokumentacioni që duhet të paraqesë për kapacitetet organizative dhe administrative.

Në pikën 16 është përcaktuar aplikuesi ose, nëse aplikuesi është bashkim, të paktën anëtari kryesues, për të plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 5, të këtij kreu, ka të drejtë të paraqesë një evidencë pasqyrash financiare të "shoqërisë mëmë".

Në pikën 17 dhe 18 është bërë përkufizimi I "Shoqëri mëmë", për efekt të zbatimit të këtij vendimi dhe në përputhje me legjislacionin që rregullon shoqëritë tregtare dhe është parashikuar se në rast se aplikuesi paraqet përvojat e operimit në fushën e lojërave të fatit dhe ato financiare të "Shoqërisë mëmë", me përjashtim të kapitalit, atëherë kjo e fundit do të jetë përgjegjëse solidare me aplikuesin për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga licencimi. Garancia e aplikimit, në këtë rast, jepet nga organet drejtuese të "Shoqërisë mëmë" që kanë të drejtë të angazhojnë këtë të fundit në të tilla marrëdhënie.

#### **Kreu IV përcaktohet procedura e shpalljes së fituesit.**

Në pikën 1 janë përcaktuar procedura që duhet të ndjekë aplikuesi në rast se aplikimi i tij është cilësuar nga komisioni si "aplikim i pranuar". Pagesat që duhet të bëjë dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojë pranë AMLF.

Në pikën 2 është përcaktuar se nëse aplikuesi është person juridik i huaj dhe/ose bashkim dhe në përputhje me pikën 1 të kreut IV, të këtij vendimi, do të krijojë një person juridik për efekt të licencimit, atëherë pronësia e aksioneve të personit juridik të krijuar sipas shkronjës së sipërpërmendur dhe çdo ndryshim në pronësinë e aplikuesit dhe ose të aksionarëve të tij, që do të sillte në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë një ndryshim në kontrollin e të licencuarit në krahasim me çastin kur aplikimi është paraqitur, duhet të bëhet me pëlqimin paraprak të AMLF.

Në pikën 3 është përcaktuar se autoriteti, brenda 5 ditëve nga çasti kur banka ka konfirmuar pagesën në llogarinë e autoritetit dhe kur aplikuesi ka plotësuar kushtet e tjera të përcaktuara në këtë vendim, i jep aplikuesit licencën për kazino, ku përcaktohen dhe kushtet për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Në pikën 4 është përcaktuar afati i dhënies së licensës dhe është përcaktuar se kjo licensë është e patransferueshme tek të tretët.

Në pikën 5 është përcaktuar se i licensuari (Aplikuesi) ka të drejtë ta fillojë veprimtarinë për kazino nga çasti i marrjes së licensës dhe pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 36 të ligjit, të këtij vendimi dhe të legjislacionit në fuqi për lojërat e fatit, në përgjithësi, në lidhje me kazinotë.

**Kreu V ka përcaktuar procedurën për pajisjen me licencë për kazino në hotel me 5 yje.**

Në pikën 1 është parashikuar se çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose i huaj, i organizuar si shoqëri aksionare, që kërkon të pajiset me licencë për Kazino në hotel me 5 yje, duhet të aplikojë pranë autoritetit të autorizuar.

Pika 2 ka parashikuar se aplikuesi që këkon të pajiset me licencë për Kazino në hotel me 5 yje duhet të vërtetojë gjatë kërkesës për aplikim se do të ushtrojë aktivitetin e tij brenda një hoteli me 5 yje.

Në pikën 3 është parashikuar se aplikuesi nuk i nënshtrohet procedurës së garës.

Pika 4 ka parashikuar se për shqyrtimin e kërkesës së aplikantit për marrjen e kësaj license do të ngrihet Komisioni i Shqyrtimit të Aplikimit për Dhënien e Licensës për Kazino në Hotel me 5 yje.

Në pikën 5 është përcaktuar se Komisioni ngrihet me Urdhër të Ministrit të Financave dhe përbëhet nga:

- a) Përfaqësues nga Ministria e Financave;
- b) Përfaqësues nga Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit;
- c) Përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomikë Tregëstisë dhe Sipërmarrjes;
- e) Përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban;
- g) Përfaqësues nga Avokatura e Shtetit;

Në pikën 6 janë parashikuar kriteret të cilat duhet të mbahen parasysh nga komisioni gjatë shqyrtimit të aplikimit janë:

- a) Çertifikimi me 5 yje i hotelit ku aplikanti do të ushtrojë aktivitetin
- b) Kontratë/akt-marrëveshje I aplikantit me hotelin e çertifikuar me 5 yje, me kohëzgjatje minimale sa afati i licensimit.
- c) Në rast se aplikuesi paraqet përvojat e operimit në fushën e lojërave të fatit dhe ato financiare të "Shoqërisë mëmë", me përjashtim të kapitalit, atëherë kjo e fundit do të jetë përgjegjëse solidare me aplikuesin për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga licensimi. Garancia e aplikimit, në këtë rast, jepet nga organet drejtuese të "Shoqërisë mëmë" që kanë të drejtë të angazhojnë këtë të fundit në të tilla marrëdhënie.
- d) Aplikuesi që këkon të pajiset me licencë për Kazino në hotel me 5 yje përveç kriterëve të sipërpërmendura, duhet të plotësojë kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.155/2015 "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë" dhe kërkesat e paraqitura në Kreun II të këtij vendimi.

**Kreu VI tregon rastet e pezullimit dhe revokimit të licensës dhe është i përbërë nga 5 pika.**

Në pikën 1 është përcaktuar se titullari i autoritetit revokon licencën e dhënë kur vërtetohet se aplikuesi ka paraqitur në aplikimin e tij një informacion të pasaktë dhe/ose të rremë apo kur në ndonjë çast gjatë ushtrimit të veprimtarisë nuk është në përputhje me kushtet, ku përfshihen edhe ndalimet dhe/ose kufizimet, që ka plotësuar si kusht për marrjen e licensës. Në rast se aplikuesi është bashkim i shoqërive, përputhja me kushtet e licencimit sipas këtij paragrafi shtrihet dhe mbi të gjithë anëtarët e bashkimit.

Pika 2 ka parashikuar se nëse lojërat e fatit, që zhvillohen në kazino, bien në kundërshtim ose cenojnë interesin e përgjithshëm publik, AMLF-ja revokon licencën për zhvillimin e tyre ose ndërpret pa paralajmërim procedurat për dhënien e licensës për organizatorin, që është në proces aplikimi.

Në pikën 3 është përcaktuar se përsëritja e shkeljeve të cilat sipas ligjit nr 155/2015 përbëjnë kundravajtje administrative, është shkak për revokimin e licensës.

Pika 4 ka parashikuar edhe rastet kur Titullari i autoritetit pezullon licencën, përveç rasteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe në rastet e mëposhtme, kur i licencuari:

- a) nuk ka përmbushur ndonjë nga kushtet e përcaktuara nga legjislacioni për lojërat e fatit;
- b) nuk kryen ndryshimet në rregulloren e lojërave dhe të kazinosë, të kërkuara nga autoriteti;
- c) nuk ka shlyer detyrimet ndaj AMLF-së dhe/ose fituesve të brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi
- d) me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të parandalimit të Pastrimit të Parave

Në pikën 5 është përcaktuar kohëzgjatja maksimale e vendosjes së pezullimit, e cila nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj nga çasti kur i licencuari ka plotësuar mospërmbushjen.

**VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT**

Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e këtij projektvendimi do të jenë Ministria e Financave dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit.

**VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT**



Projektvendimi është përgatitur nga strukturat e Ministrisë së Financave dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit. Ky projektakt është dërguar për mendim në ministritë e linjës.

Për komentet e bëra nga Ministria e Drejtësisë në shkresën nr. 289/1 datë 25.01.2017 shprehemi se:

Lidhur me komentin e parë vlerësojmë se qëllimi i nxjerrjes së këtij akti rrjedh nga ligji nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu në relacionin shoqërues të tij, është përcaktuar se qëllimi i tij është plotësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e lojrave të fati dhe përcaktimi i procedurës së zhvillimit të garës që nga kriteret e aplikimit, procedura e shpalljes së fituesit dhe rastet e pezullimit apo revokimit të licensës për subjekte të cilët do të kërkojnë të pajisen me licensën për “Kazino”. Komenti i dytë është reflektuar në përputhje me ceshtjet specifike të autorizuara nga dispozita autorizuese. Komenti i tretë është reflektuar.

Për komentet e bëra nga Avokatura e Shtetit në shkresën nr. 330/1 datë 13.02.2017, shprehemi se:

Lidhur me komentin e parë theksojmë se projektvendimi i propozuar nuk është hartuar në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit për koncensionet dhe partneritetin publik privat por me ligjin nr. 55/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”. Për sa i përket komentit të dytë, sipas të cilit institucioni i Avokaturës së Shtetit jep mendime paraprakisht për projektet e kontratave dhe marrëveshjeve të administratës publike si dhe aktete tjera që mund të passjellin pasoja financiare, vlerësojmë se procedura që rregullohet me kete projektakt perfundon me lidhjen e një kontrate, e cila për arsye të parashikimeve të saj, mund të passjellë efekte financiare për buxhetin e shtetit. Për këtë arsye është parë e nevojshme, që në Komisionin e Shqyrtimit të Aplikimeve të jetë edhe një përfaqësues i Avokaturës së Shtetit

Lidhur me komentet e bëra nga Ministria e Punëve të Brendshme në shkresën nr 286/3 datë 16.03.2017, shprehemi se:

Komenti i parë është reflektuar. Lidhur me komentin e dytë, vlerësojmë se për sa kohë që në prokurori nuk ka ende referim lidhur me veprimtarinë e aplikantit atëherë e gjykojmë të panevojshme parashikimin e një procedure para një rasti të tillë. Për më tepër që ligji 155/2015 i ka parashikuar se cili është dokumentacioni i cili duhet të paraqitet nga aplikanti për të vërtetuar gjendjen gjyqësore të tij. Vlerësojmë se kërkesa juaj në komentin e dytë tejkalon parashikimet e ligjit. Komentet e tjera janë reflektuar.

Komentet e bëra nga Ministri për Ceshtjet Vendore janë reflektuar të gjitha.

Ministria e Mjedisit me shkresën nr. 290/1 prot., datë 26.01.2017 ka shprehur dakortësinë me aktin.

Lidhur me komentet e bëra nga Ministri Për Marrëdhëniet Me Parlamentin në shkresën nr. 511/1 datë 30.01.2017, shprehemi se:

Subjektet të cilët ushtrojnë aktivitet në lojëra fati pajisen me licensë dhe ky aktivitet nuk është i hapur për të gjithë. Aplikanti duhet të përmbushë disa kritere për marrjen e kësaj license dhe eksperiencia është një prej tyre. Për të evituar krijimin e një tregu monopolistik, kemi parashikuar që aplikantet mund të paraqiten edhe në formën e një bashkimi shoqërie, duke lënë të hapur mundësinë e prurjeve të reja në treg.

Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike me shkresën nr 511/2 datë 02.02.2017 shpreh dakortësinë me projektaktin.

Ministria e Zhvillimit Urban me shkresën nr. 241/5 datë 02.02.2017 ka shprehur dakortësinë me projektaktin.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me shkresën nr. 576/1 datë 13.02.2017 është shprehur dakord me projektaktin.

Ministria e Mjedisit me shkresën nr. 613/1 datë 10.02.2017 është shprehur dakord me projektaktin.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE I SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projekt-vendim nuk përcjell efekte financiare negative në buxhetin e shtetit.

**MINISTRI I FINANCAVE**

**ARBEN AHMETAJ**